



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PËRMBARIMIT
ZYRA PËRMBARIMORE LUSHNJE

Nr. 600 Regj

Lushnje, më 13.10.2021

VENDIM SHPALLJE

(Lidhur me ekzekutimin e "Urdhërit të Ekzekutimit" të titullit ekzekutiv të debitorit)

Unë Endrin Kashari, me detyrë Kryetar i Zyrës së Përmbarrimit Lushnje, pasi studiova aktet proceduriale të çështjes përmbarrimore nr. 600, datë 29.09.2021, bazuar në urdhërin e ekzekutimit nr.890 (765), datë 20.04.2021 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë,

KONSTATOVA:

Se në datë 23.09.2021 është depozituar pranë Zyrës Përmbarrimore Lushnje kërkesa e Drejtoria Vendore e Kufirit dhe Migracionit Korçë së bashku me Urdhërin e Ekzekutimit nr. 890(765), datë 20.04.2021 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë, me palë:

- Kreditor: Drejtoria Vendore e Kufirit dhe Migracionit Korçë
- Debitor: Eduart Ilia Hoxha
- Objekti: Gjobë Administrative

Nga ana e Zyrës Përmbarrimore Lushnje ka filluar procedura në bazë të nenit 515 e vijues të K.Pr. Civile dhe ligjit nr. 8730, datë 18.01.2001 " *Për Organizimin dhe Funksionimin e Shërbimit Përmbarrimor Gjyqësor*", i ndryshuar për ekzekutimin e detyrueshëm të titullit ekzekutiv të sipërcituar. Nga verifikimi i kryer nga ana jonë në bashkëpunim me organet kompetente rezulton se debitori Eduart Ilia Hoxha nuk ka marrë dijeni nëpërmjet shërbimit postar, si rezultat i kësaj, bazuar në nenet 133/a, 133/b, 144/a dhe nenit 517 të Kodit të Procedurës Civile duhet të bëhet njoftimi me shpallje publike i debitorit lidhur me detyrimin që ka ai ndaj palës kreditore Drejtoria Vendore e Kufirit dhe Migracionit Korçë për ekzekutimin e Urdhërit të Ekzekutimit nr. 980 (765), datë 20.04.2021 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë.

Sa më sipër në mbështetje të nenit 133/a, 133/b, 144/a dhe 517 të Kodit të Procedurës Civile dhe ligjit nr. 8730, datë 18.01.2001 " *Për Organizimin dhe Funksionimin e Shërbimit Përmbarrimor Gjyqësor*", i ndryshuar,

VENDOSA:

1. Të kryej njoftimin nëpërmjet shpalljes publike me afat 20 (njëzet) ditor (duke marr parasysh edhe komunimin postar), nga data 13.10.2021 – 02.11.2021 të debitorit Eduart Ilia Hoxha;
2. Ky vendim përpilohet në pesë kopje, ku një kopje afishohet në vëndbanimin e fundit të palës debitore , një kopje afishohet në këndin e njoftimit të Zyrës Përmbaremore Lushnje, një kopje dërgohet për afishim në këndin e publikimeve të Bashkisë Divjakë, një kopje dërgohet për afishim në ambjentet e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnje dhe një kopje dërgohet për publikim në faqen zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbaremit Tiranë.
3. Kjo shpallje publike ka vlerën e aktit të njoftimit për palën debitore Eduart Ilia Hoxha me banim në Grabjan, Nj. Ad. Grabjan, Bashkia Divjakë;
4. Pala debitore Eduart Ilia Hoxha me banim në Grabjan, Nj. Ad. Grabjan, Bashkia Divjakë të paraqitet pranë Zyrës Përmbaremore Lushnje në lagjen “Çlirimi”, kati i parë, hyrja tek sekretaria e Gjykatës së Shkallës së Parë Lushnje dhe të marr kontakthe me përmbareuesin gjyqësor të çështjes përmbaremore për t’iu vënë në dispozicion aktet e dosjes përmbaremore, pasi me kalimin e këtij afati do të vijohet me ekzekutim e detyrueshëm sipas nenit 519 e ne vijim të Kodit të Proçedurës Civile.

U shpall në Lushnje, sot më datë 13.10.2021

KRYETARI I ZYRËS
Endrin Kashari

